BANKINGU QENDROR

AKTIVITETET KRYESORE TË BANKËS SË SHQIPËRISË

janar - qershor 2018

LAJME DHE NGJARJE NË 6 MUAJ

Nr. 03

WWW.BANKOFALBANIA.ORG

Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z.Gent Sejko.

EDITORIAL

Të nderuar Lexues,

Kam kënaqësinë t'ju prezantoj botimin e radhës së Revistës "Bankingu Qendror: Lajme dhe ngjarje në gjashtë muaj", për gjashtëmujorin e parë 2018.

Nëpërmjet kësaj reviste, ju sjellim të plotë e në mënyrë kronologjike veprimtarinë e Bankës së Shqipërisë për gjashtë muajt e kaluar, si dhe përpiqemi të theksojmë objektivat tanë kryesorë, në mbështetje të zhvillimit ekonomik të vendit e rritjes së mirëqenies së qytetarëve. Shpeshherë këto objektiva mund të jenë të natyrës teknike, të shtrirë në kohë e me efekt të ngadaltë, por jemi të sigurt se materializimi i tyre jep një kontribut të shtuar në përditshmërinë financiare të të gjithë qytetarëve shqiptarë.

Një ndër këto objektiva është dhe modernizimi i pagesave me vlerë të vogël, për të cilin Banka e Shqipërisë kujdeset jo vetëm si një komponent i rëndësishëm i tregjeve financiare dhe funksionimit të ekonomisë, por edhe për t'ju dhënë qytetarëve shqiptarë më shumë mundësi zgjedhjeje për kryerjen e transaksioneve të përditshme, në mënyrë të thjeshtë dhe me kosto efektive.

Prandaj, gjashtëmujori i parë i vitit 2018 e gjeti Bankën e Shqipërisë, e në veçanti Komitetin Kombëtar të Sistemeve të Pagesave (KKSP) të angazhuar në përfundimin e strategjisë së parë kombëtare për reformimin e pagesave me vlerë të vogël në Shqipëri. Kjo strategji e realizuar me mbështetjen e Bankës Botërore, u prezantua publikisht në konferencën "Modernizimi i sistemeve të pagesave me vlerë të vogël në Shqipëri", mbajtur më 21 qershor 2018. Ajo pasqyron një punë të përbashkët të të gjithë aktorëve vendas, përfshirë institucionet bankare, ato financiare jobanka, si dhe pjesë të Qeverisë Qendrore.

Strategjia parashtron një vizion të përbashkët, i cili do të shërbejë si udhërrëfyes për angazhimet e bashkërenduara të aktorëve, në periudhën afatshkurtër e afatmesme, duke synuar krijimin e një tregu bashkëkohor dhe gjithëpërfshirës për pagesat me vlerë të vogël, i mbështetur nga infrastruktura të sigurta dhe eficiente, dhe nga një gamë e gjerë instrumentesh dhe shërbimesh që përmbushin nevojat e sa më shumë përdoruesve.

Objektivat e kësaj strategjie janë të matshëm dhe transparentë për publikun, me qëllim monitorimin efikas dhe vlerësimin e ecurisë së saj. Kjo strategji synon dyfishimin e popullsisë që zotëron një llogari bankare dhe rritjen e numrit të pagesave elektronike për frymë, brenda një periudhe kohore 5-vjeçare.

Këto objektiva synohen të arrihen nëpërmjet një sërë përmirësimesh rregullative, ligjore e infrastrukturore, të cilat do t'i hapin rrugë iniciativave inovative, duke rritur kështu konkurrencën reale, për krijimin e shërbimeve me kosto të ulëta dhe lehtësisht të aksesueshme nga publiku.

Sigurisht, gjatë viteve të fundit, janë bërë hapa të dukshëm për dixhitalizimin e pagesave dhe prezantimin e shërbimeve të reja. Por ne si bankë qendrore duam të përqafojmë një strategji vizionare e moderne, të udhëhequr nga modeli i vendeve të zhvilluara dhe aspirata për rritjen e përfshirjes financiare të qytetarëve shqiptarë.

GUVERNATORI SEJKO NË FORUMIN PËR VENDET E EVROPËS QENDRORE DHE LINDORE, ORGANIZUAR NGA EUROMONEY

16-17 janar 2018, Vjenë, Austri

Në datat 16 -17 janar 2018, Euromoney organizoi Forumin për vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore në Vjenë, Austri. Ky forum zhvillohet çdo vit dhe mbledh në një tryezë të përbashkët diskutimi, personalitete të njohura ndërkombëtare nga fusha politike, ekonomike e financiare, nga vendet e EQL-së.

Punimet e këtij forumi dyditor ishin konceptuar në formën e paneleve me tema specifike, ku të pranishmit ishin të ftuar të diskutonin mbi zhvillimet më të fundit ekonomike në Evropë dhe më gjerë. Rëndësi të veçantë në këtë organizim kishin paneli dedikuar Shqipërisë dhe ai i bankave qendrore. Pjesë e tryezës dedikuar vendit tonë ishin Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z. Sejko, Zëvendësministri i Financave dhe i Ekonomisë, z. Erjon Luçi, Drejtori i Përgjithshëm i Bankës Kombëtare Tregtare, z. Seyhan Pencabligil dhe Drejtorja e Përgjithshme e Finance in Motion, zj. Elvira Lefting.

Gjatë këtij paneli, Guvernatori Sejko prezantoi një panoramë të zhvillimeve më të fundit ekonomike dhe financiare në vend, si

dhe i njohu të pranishmit me sfidat kryesore me të cilat përballet ekonomia shqiptare, në kuadrin e politikave makroekonomike dhe reformave strukturore të nevojshme për të nxitur rritjen ekonomike e përmirësimin e klimës së biznesit, si dhe për tërheqjen e investimeve të huaja në Shqipëri.

GUVERNATORI SEJKO NË TIRANA ECONOMIC FORUM, ME TEMË "BALLKANI I SË ARDHMES: DREJT NJË PËRFSHIRJEJE GLOBALE"

24 janar 2018, Tiranë

Më 24 janar 2018, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z. Gent Sejko, mori pjesë në forumin rajonal të zhvilluar nga Tirana Economic Forum, në të cilin u diskutua rëndësia e integrimit rajonal nëpërmjet temës "Ballkani i së ardhmes: Drejt një përfshirjeje globale".

Gjatë fjalës së tij, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë z. Gent Sejko, u shpreh se dialogu i orientuar drejt ndarjes së vizionit për të ardhmen, konvergjencës së këndvështrimeve mbi sfidat e të ardhmes, si edhe identifikimit të objektivave dhe hartimit të axhendave të përbashkëta të veprimit, do të ishte i frytshëm për të gjithë. Guvernatori theksoi

se konvergjenca e politikave, si brenda vendit ashtu edhe midis vendeve, promovon eficiencën dhe minimizon ndikimet negative.

Më tej, Guvernatori Sejko, theksoi se institucionet, si shtylla mbajtëse e çdo shoqërie moderne, gjenerojnë dhe zbatojnë ligje, rregullore dhe politika të zhvillimit, duke përcaktuar kështu rregullat e lojës në një ekonomi tregu. Ndaj, këto rregulla loje duhet të ofrojnë një mjedis të qëndrueshëm dhe transparent, për të mundësuar vendimmarrje të parashikueshme dhe afatgjatë, e cila do të promovojë konkurrencën e ndershme dhe barazinë e oportuniteteve, si dhe do të nxisë ndershmërinë dhe kohezionin social.

GUVERNATORI SEJKO TAKOHET ME ZËVENDËSDREJTORIN E PËRGJITHSHËM TË FMN-SË, Z. TAO ZHANG

13 shkurt 2018, Tiranë

Në datën 13 shkurt 2018, në ambientet e Bankës së Shqipërisë u zhvillua takimi mes Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, z. Gent Sejko, dhe Zëvendësdrejtorit të Përgjithshëm të Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN), z. Tao Zhang, i shoqëruar nga zj. Anita Tuladhar, Shefe e Misionit të FMN-së për Shqipërinë, dhe z. Jens Reinke, Përfaqësues Rezident i FMN-së në Shqipëri. Të pranishëm në takim ishin dhe përfaqësues të tjerë të lartë të Bankës së Shqipërisë dhe FMN-së.

Në fillim, Guvernatori Sejko vlerësoi marrëdhëniet mjaft të mira të bashkëpunimit me FMN-në, e cila, nëpërmjet ofrimit të asistencës teknike, ka ndihmuar në hartimin e reformave ekonomike dhe financiare të vendit. Guvernatori u shpreh se vëmendja e Bankës së Shqipërisë ka qenë e fokusuar në objektivin e saj kryesor, ruajtjen e stabilitetit të çmimeve, duke kontribuuar në mbështetjen e një rritjeje ekonomike të qëndrueshme dhe garantimin e stabilitetit financiar e makroekonomik të vendit. Gjatë takimit, Guvernatori Sejko bëri një ekspoze të situatës makroekonomike, ku theksoi se aktiviteti ekonomik në vend ka vijuar të shënojë përmirësim. Pavarësisht progresit, autoritetet vendase mbeten të angazhuara të japin kontributin e tyre për zhvillimin e

mëtejshëm të Shqipërisë, si dhe përshpejtimin dhe zgjerimin e reformave të ndërmarra deri tani, në kuadër të integrimit në Bashkimin Evropian.

Nga ana e tij, Zëvendësdrejtori i Përgjithshëm i FMN-së z. Tao Zhang, vlerësoi Bankën e Shqipërisë për politikat e ndërmarra, të cilat kanë kontribuuar në ruajtjen e stabilitetit makroekonomik të vendit dhe konsolidimin e vazhdueshëm të sistemit financiar në Shqipëri.

TAKIMI I GUVERNATORIT SEJKO ME GAZETARËT E EKONOMISË MBI PAKETËN E DEEUROIZIMIT

14 shkurt 2018, Tiranë

Më 14 shkurt 2018, Guvernatori Gent Sejko, zhvilloi një takim në ambientet e Bankës së Shqipërisë me gazetarët e ekonomisë. Ky takim u organizua në vijim të interesimit të shfaqur nga mediat, lidhur me masat e marra nga Banka e Shqipërisë për deeuroizimin. Gjatë këtij takimi, Guvernatori Sejko theksoi se paketa e deeuroizimit nuk duhet të shikohet si luftë ndaj euros, por si një stimulim për rritjen e përdorimit të monedhës kombëtare në ekonominë shqiptare. "Kjo paketë është ndërmarrë për të rritur fleksibilitetin dhe influencën e politikës sonë monetare, si dhe për të konsoliduar stabilitetin financiar

në Shqipëri", - u shpreh Guvernatori. Më tej, Guvernatori u prezantoi gazetarëve masat konkrete të marra nga Banka e Shqipërisë si dhe iu përgjigj pyetjeve të ngritura prej tyre.

GUVERNATORI SEJKO, NË MBLEDHJEN E KONSTITUENCËS TË FONDIT MONETAR NDËRKOMBËTAR DHE TË GRUPIT TË BANKËS BOTËRORE

16 shkurt 2018, Lisbonë, Portugali

Në datën 16 shkurt 2018, u zhvillua në Lisbonë, Portugali, Mbledhja e Konstituencës së Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN) dhe së Grupit të Bankës Botërore (BB). Ky takim mblodhi së bashku guvernatorët dhe ministrat e financave të vendeve anëtare të kësaj konstituence, për të diskutuar zhvillimet më të fundit të ekonomisë botërore dhe ekonomive përkatëse.

Banka e Shqipërisë u përfaqësua në këtë mbledhje nga Guvernatori i saj, z. Gent Sejko, i cili gjatë takimit bëri një ekspoze të situatës ekonomike dhe financiare shqiptare.

Guvernatori Sejko theksoi se aktiviteti ekonomik në vend ka vijuar të shënojë përmirësim dhe shprehu angazhimin e Bankës së Shqipërisë për të dhënë gjithë mbështetjen e duhur për të përshpejtuar aktivitetin e ardhshëm ekonomik të vendit.

Më tej, Guvernatori paraqiti pikëpamjet e Bankës së Shqipërisë mbi temat kryesore të diskutimit. Në lidhje me to, ai theksoi se Banka e Shqipërisë mirëpret rishikimet periodike të metodologjisë dhe strukturës së shpërndarjes së kuotave, por theksoi nevojën për kujdes që këto rishikime të mos cenojnë fokusin e punës dhe angazhimin e institucionit për përmbushjen e objektivave të tij.

GUVERNATORI SEJKO NË TRYEZËN E RRUMBULLAKËT ME TEMË: ''ENERGJIA DHE ZHVILLIMI I QËNDRUESHËM EKONOMIK - ROLI I DIPLOMACISË EKONOMIKE''

21 shkurt 2018, Tiranë

Në datën 21 shkurt, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z. Gent Sejko, mori pjesë në Tryezën e Rrumbullakët me temë: ''Energjia dhe zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik - Roli i diplomacisë ekonomike'', e cila u organizua nga Shoqata e Konsujve të Nderit. Gjatë

fjalës së tij përshëndetëse, Guvernatori Sejko ndau me pjesëmarrësit këndvështrimin e tij mbi rolin dhe rëndësinë e diplomacisë ekonomike, e cila duhet të synojë rritjen e interesit për investimin e kapitaleve të huaja në Shqipëri. Gjatë pesë viteve të fundit, investimet e huaja direkte kanë qenë rreth nivelit mesatar 8.7% të PBB-së, ose rreth 870 milionë euro në vit, duke na renditur në vendin e dytë në rajon, pas Malit të Zi. Megjithatë, Shqipëria vijon të mbetet e parafundit në rajon sa i takon stokut të investimeve të huaja dhe vijon të mbetet një vend me uri për investime kapitale, në të gjithë sektorët ekonomikë.

Në përfundim, Guvernatori theksoi se diplomacia ekonomike mund të bëhet më shumë pjesë e përpjekjeve për promovimin e brand-it të produkteve shqiptare, pra për zgjerimin e tregjeve dhe për rritjen e penetrimit të produkteve tona në këto tregje.

MBLIDHET GRUPI KËSHILLIMOR I STABILITETIT FINANCIAR

21 shkurt 2018, Tiranë

Në datën 21 shkurt 2018, u zhvillua mbledhja e radhës e Grupit Këshillimor të Stabilitetit Financiar (GKSF). Në këtë mbledhje morën pjesë Ministri i Financave dhe Ekonomisë (MFE), Guvernatori i Bankës së Shqipërisë (BSh), Kryetari i Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (AMF), Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së, Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Sigurimit të Depozitave (ASD) dhe përfaqësues të tjerë të këtyre institucioneve.

Në prezantimin mbi ecurinë financiare dhe vlerësimin e rreziqeve për sektorin bankar deri në fund të vitit 2017, përfaqësuesit e Bankës së Shqipërisë paraqitën një vlerësim

për veprimtarinë e sektorit bankar, mbështetur në të dhënat e tremujorit të fundit të vitit 2017. Në vijim të prezantimit, përfaqësuesit e BSH-së informuan të pranishmit mbi paketën e masave për nxitjen e përdorimit të monedhës kombëtare në veprimtarinë e bankave. Të pranishmit konfirmuan nevojën e këtyre masave dhe angazhimin e tyre për të vepruar në mënyrë të harmonizuar, në përputhje me përcaktimet e Memorandumit të Bashkëpunimit të nënshkruara midis institucioneve të sipërpërmendura për këtë qëllim.

Sipas programit, mbledhja vijoi me prezantimin e përfaqësuesve të AMF-së, lidhur me vlerësimin e gjendjes së institucioneve dhe tregjeve që mbikëqyren nga ky institucion.

BANKA E SHQIPËRISË NËNSHKRUAN NJË MEMORANDUM PËR NXITJEN E KREDITIMIT NË LEKË DHE ZHVILLIMIN E TREGUT TË KAPITALIT ME BERZH

26 shkurt 2018, Londër, Angli

Në datën 26 shkurt 2018, Guvernatori Gent Sejko, nënshkroi, në emër të Bankës së Shqipërisë, memorandumin e mirëkuptimit për nxitjen e bashkëpunimit për përdorimin e monedhës kombëtare dhe zhvillimin e tregut lokal të kapitalit në Shqipëri, midis Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), Bankës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Memorandumi synon të përmirësojë kreditimin në lekë të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme nëpërmjet një programi specifik të BERZH-it. Programi mund të ofrojë financim për këto ndërmarrje me kushte konkurruese, sipas politikave e procedurave të saj. Gjithashtu, nëpërmjet koordinimit me autoritetet kombëtare, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose në bashkëpunim me organizatat dhe partnerët ndërkombëtarë financiarë, programi nxit një mjedis pozitiv për kreditimin në monedhën vendase.

Lidhur me memorandumin, Guvernatori Sejko u shpreh se: "Roli ekskluziv që Banka e Shqipërisë ka si autoritet monetar dhe mbikëqyrës mbështetet konkretisht nga kjo marrëveshje. Angazhimi i palëve për të bashkëpunuar për përshpejtimin e zhvillimit të tregut shqiptar të kapitalit, duke forcuar përdorimin e monedhës vendase, përveç punës në fushën e mbikëqyrjes bankare dhe qeverisjes, si dhe zgjidhjes së çështjes së kredive me probleme, do të ketë një ndikim pozitiv në përmirësimin e efektivitetit të politikave ekonomike dhe financiare, si dhe reduktimin e rreziqeve të stabilitetit financiar për vendin".



PREZANTOHET PROJEKTI GREENBACK 2.0 PËR SHQIPËRINË, SI VEND PRITËS I REMITANCAVE

21 mars 2018, Tiranë

Në datën 21 mars 2018, në ambientet e Bankës së Shqipërisë, u prezantua Projekti Greenback 2.0 për Shqipërinë, si vend pritës i remitancave. Ky projekt, i cili përbën një nga komponentët e Programit të Remitancave dhe Pagesave (PRP) në Shqipëri, të financuar nga Sekretariati i Shtetit Zviceran për Çështjet Ekonomike (SECO), është një iniciativë e Bankës Botërore dhe shërben si mjet për promovimin e kanaleve të aksesueshme dhe instrumenteve të pagesave me kosto efektive për dërgimin dhe marrjen e remitancave. Banka Botërore, në bashkëpunim me Bankën e Shqipërisë, kanë zgjedhur Beratin si qytet kampion për implementimin e projektit Greenback 2.0.

Aktiviteti u hap me fjalën përshëndetëse të Zëvendësguvernatores së Parë të Bankës së Shqipërisë, zj. Elisabeta Gjoni, e cila theksoi rëndësinë që kanë dërgesat e emigrantëve për ekonominë shqiptare, si nga pikëpamja makroekonomike, ashtu edhe nga ajo e familjes në nivel mikro.

Në këtë kuadër, zj. Gjoni theksoi kontributin e remitancave në konsum, ku këto flukse vlerësohet të financojnë mbi 1/3 e familjeve, të cilat i kanalizojnë këto të ardhura për të mira të domosdoshme, edukim, shëndetësi dhe në një masë më të vogël në investime. "Sot remitancave po i kushtohet rëndësi në nivel ndërkombëtar në kuadër të një zhvillimi ekonomik të qëndrueshëm.

Për më tepër, duke qenë se ato kanë një rëndësi të veçantë për ekonominë shqiptare, ju ftojmë të vijojmë bashkëpunimin e frytshëm që kemi pasur, me qëllim përfundimin me sukses të projektit." - u shpreh zj. Gjoni.

RINOVOHET MARRËVESHJA SWAP MIDIS BANKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS QENDRORE TË REPUBLIKËS POPULLORE TË KINËS

3 prill 2018

Në datën 3 prill 2018, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z. Gent Sejko dhe Guvernatori i Bankës Qendrore të Republikës Popullore të Kinës, z. Yi Gang nënshkruan rinovimin e marrëveshjes dypalëshe SWAP për monedhat përkatëse, në shumën maksimale prej 2 miliardë Yuan ose 34.2 miliardë Lekë. Marrëveshja e re, sikurse ajo paraardhëse, është e vlefshme për një kohëzgjatje trevjeçare, duke filluar nga data e nënshkrimit të saj. Krahas nxitjes së tregtisë dypalëshe dhe investimeve direkte për zhvillimin ekonomik, marrëveshja synon edhe mbështetjen e stabilitetit financiar në vend, nëse kushtet e tregut diktojnë nevoja për një likuiditet të tillë.

PREZANTOHET RAPORTI I TRANZICIONIT TË BANKËS EVROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM, 2017-2018

11 prill 2018, Tiranë

Në datën 11 prill 2018, në ambientet e Bankës së Shqipërisë, u prezantua Raporti i Tranzicionit të Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), 2017-2018.

Në fjalën përshëndetëse të këtij aktiviteti, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z. Gent Sejko, theksoi se Raporti i Tranzicionit këtë vit ndalet në diskutimin e disa çështjeve shumë të rëndësishme për ekonomitë në tranzicion, siç janë konvergjenca e produktivitetit dhe dinamika e firmave, rëndësia e infrastrukturës rrugore për rritjen ekonomike dhe oportunitetet e reja që mund të sjellë ekonomia e gjelbër. Më tej, Guvernatori Sejko theksoi se, sipas sugjerimeve të raportit, është koha që sistemi financiar të fokusohet te ndërmarrja, si njësia bazë e punësimit, inovacionit, produktivitetit dhe rritjes ekonomike. Në përfundim, Guvernatori falënderoi dhe njëherë BERZH-in për kontributin e rëndësishëm dhe mbështetjen konkrete me investime në fusha kyçe të ekonomisë së vendit tonë, si dhe e ftoi të vazhdojë të vlerësojë potencialet që ofron Shqipëria.

Më pas, përfaqësuesit e lartë të Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim prezantuan Raportin e Tranzicionit për periudhën 2017-2018 dhe vlerësimet e tyre mbi Ballkanin Perëndimor, si dhe iu përgjigjën interesit të të pranishmëve.

GUVERNATORI SEJKO NË KONFERENCËN E 7-TË VJETORE TË KËRKIMEVE TË BANKËS KOMBËTARE TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

13 prill 2018, Ohër, Maqedoni

Më 13 prill 2018, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z. Gent Sejko, mori pjesë në Konferencën e 7-të vjetore të Kërkimeve të organizuar nga Banka Kombëtare e Republikës së Maqedonisë, me temë "Rreth një dekadë pas krizës: drejt një cikli të ri global dhe normalizimit të politikës monetare", në Ohër, Maqedoni.

Gjatë punimeve të konferencës, Guvernatori Sejko bëri një ekspoze të situatës ekonomike shqiptare, duke u ndalur te zhvillimet ekonomiko-financiare dhe ndikimet e mundshme të normalizimit të politikës monetare. Ai theksoi se Banka e Shqipërisë mbetet e gatshme të marrë të gjitha masat e nevojshme duke dhënë kontributin e saj në mbështetje të një rritjeje ekonomike të qëndrueshme dhe garantimit të stabilitetit makroekonomik të vendit. Ai shtoi se politika monetare lehtësuese e ndjekur nga Banka e Shqipërisë ka ulur kostot e financimit të sektorit privat, ka nxitur rritjen e kreditimit në lekë dhe ka ndihmuar në përmirësimin e gjendjes financiare të huamarrësve. Guvernatori Sejko nënvizoi rëndësinë e reformave të mëtejshme për të përmirësuar modelin e zhvillimit të vendit dhe ambientin e biznesit, si dhe për të ecur përpara në procesin e integrimit evropian. Në përfundim, Guvernatori Sejko u shpreh se e ardhmja politike afatgjatë dhe prosperiteti ekonomik, lidhen ngushtë me procesin e integrimit në Bashkimin Evropian.

GUVERNATORI I BANKËS SË SHQIPËRISË, Z. GENT SEJKO, NË MBLEDHJET E PRANVERËS TË FONDIT MONETAR NDËRKOMBËTAR DHE BANKËS BOTËRORE

20-22 prill 2018, Uashington, SHBA

Në datat 20-22 prill 2018, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z. Gent Sejko, mori pjesë në Mbledhjet e Pranverës të Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN) dhe të Grupit të Bankës Botërore (BB), në Uashington.

Gjatë pjesëmarrjes në këto mbledhje, Guvernatori Sejko, zhvilloi disa takime të rëndësishme me personalitete të njohura të fushës financiare ndërkombëtare. Në këto

takime, Guvernatori i njohu të pranishmit me zhvillimet më të fundit në ekonominë shqiptare, duke u ndalur në perspektivën e rritjes ekonomike dhe në zhvillimet e sektorit bankar. Guvernatori theksoi se rritja ekonomike e vendit është në një trajektore pozitive zhvillimi. Ai shtoi se zbatimi i politikës monetare stimuluese ka mbështetur rritjen e ekonomisë, të punësimit e pagave, si dhe të inflacionit. Më konkretisht, në lidhje me

zhvillimet në ecurinë e çmimeve të konsumit, z. Sejko u shpreh se Banka e Shqipërisë ka qenë e fokusuar në përmbushjen e objektivit të saj kryesor, ruajtjen e stabilitetit të çmimeve. Në përfundim, Guvernatori Sejko shtoi se institucioni që ai drejton do të vijojë me përmirësimin e vazhdueshëm të rolit të tij mbikëqyrës, përqasjes proaktive të rregullimit bankar, rritjes së sigurisë së sistemit bankar dhe nxitjes së zhvillimit të sistemit të pagesave, duke ndjekur standardet ndërkombëtare.

Përfaqësuesit e lartë të FMN-së dhe BB-së vlerësuan pozitivisht rolin dhe politikën e ndjekur nga Banka e Shqipërisë, në zhvillimin makroekonomik dhe stabilitetin financiar të vendit. Gjithashtu, përfaqësuesit e lartë të FMN-së dhe BB-së gjetën rastin të inkurajonin Bankën e Shqipërisë në angazhimin e mëtejshëm lidhur me planin e masave për reduktimin e kredive me probleme, nxitjen e kreditimit dhe stimulimin e përdorimit të monedhës kombëtare.

Më tej, zyrtarët e lartë ndërkombëtarë theksuan se Shqipëria duhet të përfitojë nga trendi i rritjes ekonomike, stabiliteti financiar dhe sistemi i sigurt financiar, për të tërhequr investime të huaja, në mënyrë që kjo rritje ekonomike të jetë e shëndetshme në afat të gjatë.

GUVERNATORI SEJKO PREZANTON RAPORTIN VJETOR TË BANKËS SË SHQIPËRISË PËR VITIN 2017

Në datë 10 prill 2018, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z. Gent Sejko, prezantoi përpara deputetëve të Komisionit të Ekonomisë dhe Financave, Raportin Vjetor të Bankës së Shqipërisë për vitin 2017. Ndërsa në datën 17 maj 2018, Guvernatori e prezantoi këtë Raport përpara deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë.

Raportimi në Kuvendin e Shqipërisë është detyrim ligjor, i cili përmbush procesin llogaridhënës të institucionit për veprimtarinë e vitit të kaluar ushtrimor, si dhe njeh ligjvënësit me disa nga objektivat kryesorë, që do të udhëheqin punën e Bankës së Shqipërisë në periudhat në vijim.

Gjatë fjalës së tij, Guvernatori Sejko bëri një ekspoze të panoramës ekonomike e financiare të vendit, duke e cilësuar vitin

2017 si një vit progresi për ekonominë dhe për sistemin financiar shqiptar. Më konkretisht, Guvernatori u ndal në kontributin që Banka e Shqipërisë ka dhënë në përmirësimin e ambientit ekonomik e financiar nëpërmjet:

- zbatimit të një politike monetare stimuluese, e cila mbështeti rritjen e ekonomisë, punësimit, pagave dhe inflacionit;
- mbikëqyrjes së kujdesshme dhe përqasjes proaktive të rregullimit bankar, duke ndihmuar përmirësimin e treguesve të aktivitetit të sektorit bankar;
- rritjes së sigurisë së sistemit bankar, përmes ngritjes së strukturave të specializuara për të administruar ndërhyrjet e ristrukturimet e nevojshme tek bankat me vështirësi paguese;
- nxitjes së zhvillimit e funksionimit eficient të sistemit të pagesave;
- nxitjes së edukimit financiar;
- forcimit të mëtejshëm të institucionit të bankës qendrore, falë investimit të vazhdueshëm për rritjen e profesionalizmit, të pavarësisë, llogaridhënies dhe transparencës, si dhe përmes bashkëpunimit e shkëmbimit të informacioneve e opinioneve me partnerë të brendshëm e të jashtëm.

Më tej, Guvernatori shtoi se aktiviteti i Bankës së Shqipërisë, gjatë vitit të shkuar, ka qenë në përputhje me detyrat ligjore dhe në linjë me Rekomandimet e Kuvendit. Ai theksoi faktin se, pavarësisht premisave pozitive të zhvillimit, ekonomia shqiptare vazhdon të përballet me sfida afatmesme dhe

afatgjata zhvillimi. Identifikimi dhe reduktimi i vulnerabiliteteve ekonomike e financiare, shmangia e rreziqeve potenciale, si dhe vazhdimi i reformave strukturore në interes të përshpejtimit të ritmit të rritjes së vendit, janë disa nga sfidat kryesore me të cilat përballemi. "Detyra jonë si politikëbërës është hartimi dhe zbatimi i planeve konsistente dhe konsekuente të veprimit, për të adresuar në kohë të gjitha problemet me të cilat përballemi"- u shpreh Guvernatori.

Në përfundim të fjalës së tij, Guvernatori siguroi se Banka e Shqipërisë do të vijojë të mbetet e përkushtuar për respektimin e objektivave të saj ligjorë, si dhe për zbatimin e detyrave e angazhimeve institucionale.

GUVERNATORI SEJKO NË KLUBIN E GUVERNATORËVE TË VENDEVE TË AZISË QENDRORE, RAJONIT TË DETIT TË ZI DHE TË BALLKANIT

13-15 maj 2018, Bodrum, Turqi

Në datat 13-15 maj 2018, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z. Gent Sejko, mori pjesë në takimin e 39-të të Klubit të Guvernatorëve të vendeve të Azisë Qendrore, Rajonit të Detit të Zi dhe Ballkanit. Ky takim u zhvillua në Bodrum të Turqisë, me pjesëmarrjen

e drejtuesve të bankave qendrore të vendeve anëtare të Klubit, si dhe përfaqësuesve të lartë të Fondit Monetar Ndërkombëtar, Bankës Qendrore Evropiane dhe Bankës për Rregullime Ndërkombëtare. Aktiviteti u hap me fjalën përshëndetëse të Guvernatorit të Bankës Qendrore të Republikës së Turqisë, z. Murat Çetinkaya.

Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z. Gent Sejko, ishte folësi kryesor i panelit me temë "Rritja e qëndrueshme globale". Ai mbajti një prezantim për të pranishmit, duke vlerësuar fillimisht rëndësinë e pjesëmarrjes në aktivitete të tilla, si një mundësi për të ndarë pikëpamjet e përvojat, si dhe për të vlerësuar përparimin e kryer dhe për të reflektuar mbi prioritetet në të ardhmen. Guvernatori u shpreh se pas tejkalimit të krizës financiare, ekonomia globale po fiton ritëm. Ai shtoi se fokusi i vendeve ka qenë trajtimi i pasojave të krizës dhe nxitja e një rimëkëmbjeje sa më të shpejtë.

Në përfundim, Guvernatori Sejko nënvizoi se korrigjimi i problemeve të së kaluarës dhe vendosja e ekonomisë globale në rrugën e rritjes së qëndrueshme është një përgjegjësi e përbashkët. Të gjithë ndajmë përfitimet e rritjes globale dhe së bashku duhet të ndajmë përgjegjësinë për të siguruar qëndrueshmërinë e saj.

INTERVISTË E ZËVENDËSGUVERNATORES GJONI PËR REVISTËN "MONITOR"

21 maj 2018, Tiranë

Në një intervistë për revistën ekonomike "Monitor", Zëvendësguvernatorja e Parë e Bankës së Shqipërisë, zj. Elisabeta Gjoni shpjegon prirjen afatgjatë dhe mbiçmuese të monedhës kombëtare Lek, duke qartësuar se procesi i deeuroizimit nuk ka pasur ndikim. Zëvendësguvernatorja Gjoni pohoi se arsyet kryesore që kanë ndikuar në tendencën mbiçmuese të lekut lidhen me përmirësime strukturore në ekonominë shqiptare, si: rritja e eksporteve, investimeve të huaja, të ardhurave nga turizmi dhe rënia e preferencës për të mbajtur aktivet në euro për shkak të normës së ulët të interesit.

Gjatë intervistës, Zëvendësguvernatorja shpjegon se Shqipëria është një vend me nivel të lartë përdorimi të monedhave të huaja (e quajtur ndryshe euroizim) dhe kjo është arsyeja kryesore për të cilën u prezantua strategjia e deeuroizimit. "Niveli i lartë i përdorimit të monedhave të huaja në ekonomi e ekspozonte ekonominë ndaj rreziqeve, si në aspektin makro, ashtu dhe në stabilitetin financiar të vendit.", u shpreh zj. Gjoni.

Në përfundim, Zëvendësguvernatorja Gjoni pohoi se Banka e Shqipërisë nuk influencon apo përpiqet të influencojë ecurinë e kursit të këmbimit, kur kjo lëvizje është në përputhje me fondamentet. Megjithatë, ajo shtoi se, në rast se kursi i këmbimit do të frenojë kthimin e inflacionit në objektiv, përtej parashikimeve, atëherë Banka e Shqipërisë mbetet e gatshme të reagojë, nëpërmjet instrumenteve konvencionale në dispozicion dhe në përputhje me regjimin e politikës monetare.

BANKA E SHQIPËRISË DHE BANKA QENDRORE EVROPIANE ORGANIZOJNË SEMINARIN RAJONAL NË FUSHËN E STATISTIKAVE TË BANKËS QENDRORE

13-14 qershor 2018, Tiranë

Në datat 13-14 qershor 2018, Banka e Shqipërisë dhe Banka Qendrore Evropiane (BQE), organizuan seminarin rajonal në fushën e statistikave të bankës qendrore. Ky seminar organizohet rregullisht nga BQE-ja me një bankë qendrore dhe siguron një forum të rëndësishëm për shkëmbimin e pikëpamjeve mbi kërkesat statistikore, hartimin e politikave dhe diskutimin e risive më të fundit në çështjet statistikore të bankingut qendror. Qëllimi i tij është realizimi i diskutimeve dhe këmbimi i këndvështrimeve mbi statistikat, si një nga çështjet më sfiduese

dhe themelore për bankierët qendrorë dhe politikëbërësit në përgjithësi.

Në krye të fjalës përshëndetëse, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z. Gent Sejko, u shpreh se të dhënat e besueshme, të mjaftueshme dhe të ofruara në kohë, janë element i domosdoshëm për një vendimmarrje sa më të mirë. Më tej, Guvernatori nënvizoi se sot nevojitet të jemi të informuar dhe t'i analizojmë të dhënat ekonomike në dimensione të ndryshme dhe në shkallë granulare. Për këtë qëllim, Banka e Shqipërisë ka punuar në disa dimensione për pasurimin dhe përmirësimin e informacionit statistikor.

Në përfundim, Guvernatori shtoi se bashkërendimi ndërinstitucional është çelësi i suksesit për prodhimin e të dhënave statistikore shumëdimensionale. Ai theksoi rëndësinë e bashkëpunimit midis Bankës së Shqipërisë dhe INSTAT-it, i cili deri tani ka rezultuar mjaft i suksesshëm dhe i tillë do të vazhdojë të jetë edhe në të ardhmen.

GUVERNATORI SEJKO NË SAMITIN E VENDEVE TË RAJONIT, ME TEMË "STABILITETI FINANCIAR DHE MONETAR NË RAJON, 10 VJET PAS KRIZËS FINANCIARE GLOBALE"

14-16 qershor 2018, Becic, Mal i Zi

Në datat 14-16 qershor 2018, u zhvillua samiti vjetor i vendeve të rajonit me temë "Stabiliteti financiar dhe monetar në rajon, 10 vjet pas krizës financiare globale". Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z. Gent Sejko, ishte pjesë e këtij samiti, i cili zhvilloi punimet e tij në Becic, Mal i Zi, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të lartë të bankave qendrore të Malit të Zi, Maqedonisë, Bosnje-Hercegovinës, Kroacisë, Kosovës, Serbisë, si dhe ministrave të financave dhe drejtorë të tatimeve nga vendet e rajonit.

Paneli i guvernatorëve, në të cilin Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z. Gent Sejko, ishte i ftuar të mbante një fjalë për të pranishmit, diskutoi rreth temës "Politika monetare dhe stabiliteti i sistemeve bankare në vendet e rajonit – Një dekadë pas falimentimit të Lehman Brothers". Në fjalën e tij, Guvernatori prezantoi një nga çështjet më sfiduese me të cilën Banka e Shqipërisë po përballet aktualisht, ecurinë e kursit të këmbimit. Guvernatori u shpreh se regjimi i shënjestrimit të inflacionit dhe regjimi i kursit të lirë të këmbimit, të cilët janë zgjedhur dhe zbatohen në Shqipëri, kanë funksionuar më së miri dhe kanë ndihmuar Shqipërinë në procesin e konvergjencës, duke mundësuar norma të larta rritjeje ekonomike, stabilitet ekonomik e financiar, dhe rritje e zgjerim të sektorit financiar. Në veçanti, ai

theksoi se regjimi i kursit të lirë të këmbimit ka rritur fleksibilitetin e Bankës së Shqipërisë në përballimin e goditjeve dhe ka ndihmuar në reduktimin e kostove të tyre. Në vazhdim, Guvernatori theksoi se, edhe në regjime të lira të kursit të këmbimit, politika monetare duhet të mbajë parasysh, në mënyrë konsistente dhe koherente, lëvizjet e kursit të këmbimit, për sa kohë dhe në masën që këto lëvizje ndikojnë ecurinë e inflacionit.

GUVERNATORI I BANKËS SË SHQIPËRISË TAKON AMBASADOREN E REPUBLIKËS FRANCEZE NË TIRANË, SH.S.ZJ. CHRISTINA VASAK, DHE SHEFIN E SEKTORIT EKONOMIK RAJONAL, REZIDENT NË SOFJE, Z. JEAN-MARIE DEMANGE

20 qershor 2018, Tiranë

Në datën 20 qershor 2018, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z. Gent Sejko, zhvilloi një takim me Ambasadoren e Republikës Franceze në Tiranë, SH.S.Zj. Christina Vasak, dhe Shefin e Sektorit Ekonomik Rajonal, rezident në Sofje, z. Jean-Marie Demange, në ambientet e Bankës së Shqipërisë.

Guvernatori i Bankës së Shqipërisë prezantoi Ambasadoren dhe z. Demange me zhvillimet ekonomike në vend, ku theksoi se rritja ekonomike është në trajektore pozitive zhvillimi dhe balancat kryesore ekonomike pritet të forcohen në vitet e ardhshme. Gjatë takimit, u diskutua në lidhje me sistemin financiar, si dhe rolin mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, me qëllim forcimin e qëndrueshmërisë së sistemit, në kuadër edhe të parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Guvernatori theksoi se ky është një proces mjaft i rëndësishëm dhe se institucionet në vend po bashkëpunojnë nëpërmjet shkëmbimit të informacionit, duke synuar forcimin e përqasjes së mbikëqyrjes të bazuar në rrezik.

Në përfundim, bashkëbiseduesit ndanë të njëjtin mendim mbi perspektivat për rritjen e mëtejshme të bashkëpunimit ekonomik midis dy vendeve, nëpërmjet projekteve potenciale në sektorë të ndryshëm të ekonomisë, si ai financiar dhe infrastrukturor, si dhe rritjen e investimeve të huaja në Shqipëri.

MBLEDHJA E KATËRT E KOMITETIT KOMBËTAR TË SISTEMIT TË PAGESAVE

20 qershor 2018, Tiranë

Në datën 20 qershor 2018, u zhvillua mbledhja e katërt vjetore e Komitetit Kombëtar të Sistemit të Pagesave (KKSP), nën drejtimin e Kryetares së tij, zj. Elisabeta Gjoni, Zëvendësguvernatore e Parë e Bankës së Shqipërisë. Në këtë mbledhje, përveç anëtarëve të Komitetit, ishin të pranishëm dhe përfaqësues nga Banka Botërore, ekspertë për sistemin financiar dhe sistemet e pagesave.

Gjatë mbledhjes, Komiteti miratoi strategjinë "Për zhvillimin e pagesave me vlerë të vogël" dhe paraqiti projektet e realizuara deri tani në lidhje me këtë strategji, në kuadër të modernizimit të sistemeve të pagesave. Vizioni i strategjisë është "krijimi i një tregu bashkëkohor dhe gjithëpërfshirës për pagesat me vlerë të vogël, i mbështetur nga infrastruktura të sigurta dhe eficiente, dhe nga një gamë e gjerë instrumentesh dhe shërbimesh që përmbushin nevojat e përdoruesve". Strategjia synon edhe përmirësimin e kuadrit ligjor dhe rregullativ, ku si nismë konkrete Komiteti diskutoi projektligjin "Për shërbimet e pagesave", i cili transpozon direktivën përkatëse të rishikuar të Bashkimit Evropian.

BANKA E SHQIPËRISË ORGANIZON KONFERENCËN ME TEMË "MODERNIZIMI I SISTEMEVE TË PAGESAVE ME VLERË TË VOGËL"

21 qershor 2018, Tiranë

Në datën 21 qershor 2018, në ambientet e Bankës së Shqipërisë u zhvillua konferenca me temë "Modernizimi i sistemeve të pagesave me vlerë të vogël". Në këtë konferencë, pjesëmarrës ishin përfaqësues nga Banka Botërore, Banka Qendrore Evropiane, bankat qendrore të rajonit, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Shoqata Shqiptare

e Bankave dhe përfaqësues nga komuniteti i biznesit.

Konferenca u çel nga Zëvendësguvernatorja e Parë e Bankës së Shqipërisë, njëherazi kryetare e Komitetit Kombëtar të Sistemit të Pagesave, zj. Elisabeta Gjoni, si dhe u përshëndet nga Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z. Gent Sejko, dhe Zëvendëskryeministrja e Republikës së Shqipërisë, zj. Senida Mesi.

Më tej, konferenca i zhvilloi punimet në një nivel më teknik, gjatë të cilës përfaqësues nga Banka Qendrore Evropiane, Banka Botërore, Banka e Italisë, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Banka Kombëtare e Serbisë, operatorë dhe ofrues të shërbimeve në fushën e pagesave, të mirënjohur në tregun ndërkombëtar, përfaqësues të industrisë bankare e të pagesave në Shqipëri prezantuan për të pranishmit zhvillimet kryesore, projektet dhe përvojën e tyre në fushën e sistemeve të pagesave me vlerë të vogël.

GUVERNATORI SEJKO NË TAKIM ME PËRFAQËSUES TË FONDIT EVROPIAN PËR EVROPËN JUGLINDORE

21 qershor 2018, Tiranë

Më datë 21 qershor 2018, Guvernatori Gent Sejko, zhvilloi një takim në ambientet e Bankës së Shqipërisë me përfaqësues të Fondit Evropian për Evropën Juglindore (EFSE), kryesuar nga z. Christoph Tiskens, Kryetar i Bordit të këtij Fondi. Takimi u çel me një ekspoze të Guvernatorit Sejko mbi zhvillimet më të fundit ekonomike të sektorit financiar dhe bankar në Shqipëri, me një theks të veçantë në vendimmarrjen e fundit të Bankës së Shqipërisë lidhur me inflacionin dhe kursin e këmbimit.

Guvernatori u shpreh se mjedisi makroekonomik vlerësohet i qëndrueshëm dhe prospektet tregojnë ruajtjen e ritmit pozitiv të rritjes së ekonomisë. Ai shtoi se zhvillimet e ekonomisë janë optimiste, veçanërisht për sektorin e turizmit duke vënë theksin te potenciali që ka ky sektor në të ardhmen. Lidhur me zhvillimet financiare në vend, Guvernatori nënvizoi se sistemi bankar shqiptar shfaqet me tregues mjaft të mirë financiarë, është i kapitalizuar, likuid dhe financiarisht i shëndetshëm.

Gjatë takimit u diskutua mbi bashkëpunimin midis dy institucioneve, ku u vlerësua se duhet punuar më shumë për një akses më të mirë në financa, të sektorit të ndërmarrjeve të vogla. Për këtë qëllim, EFSE është e angazhuar të ofrojë mbështetjen e saj si në fonde ashtu edhe në njohuri, në mënyrë që kostot që shoqërojnë kreditimin e këtij segmenti të vijnë duke u reduktuar.

Nga ana e tij, zoti Tiskens u shpreh se vlerëson mbështetjen e vazhdueshme të Bankës së Shqipërisë ndër vite për çdo iniciativë të ndërmarrë nga EFSE. Shqipëria, si një nga vendet e para aksionare të EFSE-s, me kontribut të spikatur ndër vite në veprimtarinë e këtij fondi, zë një vend të rëndësishëm në optikën e tij. Z. Tiskens i kushtoi një theks të veçantë gjallërimit ekonomik të momentit si dhe aksesit të përmirësuar të ndërmarrjeve dhe individëve në shërbimet financiare.

ZËVENDËSGUVERNATORJA AHMETAJ NË FORUMIN "RRITJA E EDUKIMIT FINANCIAR PËR PËRFSHIRJEN FINANCIARE"

29 qershor 2018, Tiranë

Në datën 29 qershor 2018, zhvilloi punimet forumi me temë "Rritja e edukimit financiar për përfshirjen financiare", organizuar nga Shoqata Shqiptare e Bankave në bashkëpunim me Bankën e Shqipërisë.

Punimet e këtij forumi u përshëndetën nga Zëvendësguvernatorja e Dytë e Bankës së Shqipërisë, zj. Natasha Ahmetaj. Në fjalën e saj, Zëvendësguvernatorja Ahmetaj theksoi se Banka e Shqipërisë është ndër bankat qendrore pioniere në rajon për përfshirjen

konkrete në edukimin financiar të publikut. Përmes edukimit financiar të publikut, Banka e Shqipërisë e ka më të lehtë të komunikojë në mënyrë të kuptueshme vendimet e politikës monetare, veprimet e mosveprimet, qëllimin dhe strategjinë për arritjen e tij. Vetëm përmes këtij edukimi, publiku ndërton besimin tek banka qendrore dhe kupton pse stabiliteti i çmimeve, që përbën objektivin parësor të saj, është në fund të fundit një e mirë publike.

Në përfundim, ajo theksoi se Banka e Shqipërisë kujdeset që sistemi financiar të sigurojë shërbimet financiare dhe akses në kredi në mënyrë sa më të drejtë. Për këtë, Banka e Shqipërisë nga njëra anë rregullon dhe mbikëqyr sistemin dhe nga ana tjetër, angazhon mjaft kapacitete të vetat në fushën e edukimit ekonomik dhe financiar. Nëse përfshirja financiare vjen duke u përmirësuar, do të thotë se publiku po bëhet gjithnjë e më shumë pjesë e sistemit financiar, po përdor produktet e tij, po jep kështu kontribut për zgjerimin e ndërmjetësimit financiar. Nëse ky ndërmjetësim zgjerohet, ekonomia ushqehet me fonde, projekte të reja jetësohen, potenciali i ekonomisë zgjerohet, duke realizuar kështu qëllimin final: rritjen e mirëqenies për të gjithë.

TË TJERA

BANKA E SHQIPËRISË I KOMUNIKON PUBLIKUT VENDIMMARRJEN E POLITIKËS MONETARE

Pas çdo mbledhjeje të Këshillit Mbikëqyrës, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë i komunikon publikut vendimmarrjen e Bankës së Shqipërisë, në një konferencë për shtyp.

Sipas kalendarit të publikuar në fillim të vitit, gjatë 6-mujorit të parë të vitit 2018, janë zhvilluar tre konferenca për shtyp të Guvernatorit mbi këtë vendimmarrje, përkatësisht më: 7 shkurt, 28 mars, 2 maj, si dhe një konferencë e veçantë në datë 6 qershor 2018, nisur nga vlerësimi se mbiçmimi i monedhës vendase po kthehej në një rrezik për arritjen e objektivit të synuar të inflacionit prej 3%.

Në këtë konferencë, Guvernatori Sejko i komunikoi publikut të gjerë vendimmarrjen e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë lidhur uljen e normës bazë të interesit me 0.25 pikë përqindje në nivelin 1.00%, të normës së interesit të depozitës njëditore në nivelin 0.10%, si dhe të normës së interesit të kredisë njëditore në nivelin 1.90%. Gjithashtu, nisur nga nevoja e krijimit të kushteve të duhura monetare për ruajtjen e stabilitetit të çmimeve, si dhe duke reflektuar mbi reduktimin e hapësirës së përdorimit të instrumentit tradicional të politikës monetare, normës bazë të interesit, Këshilli Mbikëqyrës vendosi ndërmarrjen e operacioneve të blerjes së valutës në tregun e brendshëm valutor. Guvernatori Sejko theksoi se këto operacione do të ndërmerren në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullativ dhe do të synojnë eliminimin e tepricës së përkohshme të valutës në treg dhe frenimin e forcimit të mëtejshëm të kursit të këmbimit, forcim i cili do të dëmtonte përmbushjen e objektivit të Bankës së Shqipërisë për stabilitetin e çmimeve.

PREZANTIMET PËR MEDIAN TË RAPORTEVE PERIODIKE TË BANKËS SË SHQIPËRISË

Si pjesë e strategjisë së saj të komunikimit me publikun, Banka e Shqipërisë i prezanton medias raportet e saj periodike, përpara publikimit të tyre. Gjatë 6-mujorit të parë të këtij viti, janë zhvilluar 4 prezantime "off the records" për mediat:

- prezantimi i Raportit të Politikës Monetare 2018/I në datën 15 janar 2018, në ambientet e Bankës së Shqipërisë
- prezantimi i Raportit të Stabilitetit Financiar 6M II 2017, në datën 26 prill 2018, në ambientet e Bankës së Shqipërisë;
- prezantimi i Raportit të Politikës Monetare 2018/II, në datën 10 maj 2018, në ambientet e Bankës së Shqipërisë;
- prezantimi i Raportit Vjetor të Mbikëqyrjes për vitin 2017, në datën 28 qershor 2018, në ambientet e Bankës së Shqipërisë.

BANKA E SHQIPËRISË PREZANTON FAQEN E RE TË INTERNETIT

Më 1 mars 2018, Banka e Shqipërisë publikoi faqen e saj të re të internetit, me qëllim përcjelljen sa më qartë të filozofisë së saj të komunikimit dhe përshtatjen me sjelljen gjithnjë në ndryshim të përdoruesve dixhitalë. Faqja e internetit www.bankofalbania.org përfaqëson një nga mjetet kryesore të komunikimit të Bankës së Shqipërisë me publikun e gjerë, ndaj i është kushtuar një rëndësi e veçantë cilësisë, paraqitjes vizuale dhe lehtësisë në përdorim. Me një dizajn të ri, modern e më tërheqës, faqja e internetit vjen te publiku në një format të rikonceptuar, duke u fokusuar te përdorimi më i lehtë nga publiku. Me publikimin e faqes së re, Banka e Shqipërisë përmbush një nga objektivat kryesorë të strategjisë afatmesme të zhvillimit për periudhën 2018-2020, që synon rritjen e transparencës mbi veprimtarinë e saj përmes një komunikimi të hapur me publikun.



BANKA E SHQIPËRISË HEDH NË QARKULLIM MONEDHËN METALIKE ME KURS LIGJOR, ME VLERË NOMINALE 20 LEKË, EMETIM I VITIT 2016

Duke filluar nga data 30 mars 2018, Banka e Shqipërisë hedh në qarkullim monedhën metalike shqiptare me vlerë nominale 20 Lekë, me kurs ligjor, emetim i vitit 2016. Monedha e re ka të njëjtën përbërje, pamje, përmasa dhe peshë me monedhën e të njëjtës prerje të emetuar në vitin 2012, por ndryshon viti i emetimit të shtypur në trupin e monedhës metalike, që do të jetë "2016", si dhe drejtshkrimi i fjalëve "LEKË", dhe "SHQIPËRISË". Kjo monedhë do të përdoret si mjet pagese paralelisht me të gjitha monedhat metalike ekzistuese në qarkullim të kësaj prerjeje, emetime të viteve të mëparshme.

SEMINARET E TË PREMTES

Banka e Shqipërisë organizon rregullisht aktivitetin me natyrë kërkimore "Seminari i të Premtes". Kjo nismë fton punonjësit e

Bankës së Shqipërisë, kërkuesit e sferës akademike dhe të institucioneve të tjera financiare dhe kërkimore të prezantojnë dhe të diskutojnë materialet e tyre kërkimore, teorike dhe empirike. Gjatë gjashtëmujorit të parë u prezantuan këto punime:

- "Ndikimi i shëndetit financiar të bankave dhe firmave në koston e huamarrjes: Çfarë sugjerojnë të dhënat?", me autor Bledar Hodën, më 24 janar 2018;
- "Ndërmarrjet bujqësore dhe financimi i tyre në Shqipëri", u prezantua nga autorët zj. Elona Dushku dhe z. Kliti Ceca, më 9 mars 2018.

AKTIVITETE TË MUZEUT TË BANKËS SË SHQIPËRISË

AKTIVITETE NË KUADËR TË VITIT MBARËKOMBËTAR TË GJERGJ KASTRIOT SKËNDERBEUT

Në kuadër të vitit mbarëkombëtar të Gjergj Kastriotit Skënderbeut, të kremtuar në 550-vjetorin e vdekjes së Heroit tonë Kombëtar (1468-2018), Banka e Shqipërisë u bë pjesë e kremtimeve jo vetëm përmes dedikimit të kalendarit të saj për vitin 2018, por edhe përmes disa aktiviteteve.

MUZEU I BANKËS SË SHQIPËRISË ÇEL EKSPOZITËN E PËRKOHSHME "GJERGJ KASTRIOTI SKËNDERBEU NË MONEDHËN DHE KARTËMONEDHËN SHQIPTARE"

17 janar – 28 nëntor 2018, Tiranë

Më 17 janar 2018, Muzeu i Bankës së Shqipërisë, në përkujtim të 550-vjetorit të vdekjes së Heroit Kombëtar Gjergj Kastrioti Skënderbeut, çeli ekspozitën e përkohshme "Gjergj Kastrioti Skënderbeu në monedhën dhe kartëmonedhën shqiptare".

Muzeu i Bankës së Shqipërisë ia kushton ekspozitën figurës së Gjergj Kastrioti Skënderbeut të paraqitur në monedhën dhe kartëmonedhën shqiptare, prej vitit 1921 deri në vitin 1996, si dhe pasuruar me elemente të ndryshme shtypi të këtyre prerjeve. Ndër të tjera, kjo ekspozitë synon të sjellë në kujtesën e publikut, se ashtu si gjatë Rilindjes Kombëtare, edhe në ditët tona, Gjergj Kastrioti Skënderbeu është personaliteti më i hasur në monedhën kombëtare gjatë rrugëtimit të saj thuajse 100-vjeçar.

Banka e Shqipërisë përmes një ftese të hapur në rrjetet sociale mirëpriti në këtë ekspozitë përfaqësues të medias, sistemit bankar, edukimit, artit dhe kulturës, si dhe të apasionuar pas numizmatikës, koleksionistë etj.

BANKA E SHQIPËRISË, NË BASHKËPUNIM ME BANKËN QENDRORE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, ÇEL EKSPOZITËN E PËRKOHSHME "GJERGJ KASTRIOTI SKËNDERBEU NË MONEDHËN DHE KARTËMONEDHËN SHQIPTARE"

10-12 qershor 2018, Prizren, Kosovë

Në datat 10-12 qershor 2018, në kuadër të Vitit Mbarëkombëtar të Gjergj Kastrioti Skënderbeut, Banka e Shqipërisë, në bashkëpunim me Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, çeli ekspozitën "Gjergj Kastrioti Skënderbeu në monedhën dhe kartëmonedhën shqiptare". Kjo ekspozitë

u vendos në ambientet e Ndërtesës së Lidhjes në qytetin e Prizrenit dhe çelja e saj përkoi me përvjetorin e 140-të të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Në ceremoninë e çeljes së ekspozitës, ishin të pranishëm Presidenti i Republikës së Shqipërisë Sh.T.Z. Ilir Meta, Kryeministri i Kosovës, z. Ramush Haradinaj, si dhe një sërë personalitetesh të rëndësishme shqiptare dhe kosovare.

Koleksioni i përzgjedhur nga Banka e Shqipërisë për këtë ekspozitë përmban monedha dhe kartëmonedha shqiptare të viteve 1921-1996, të cilat paraqesin Heroin Kombëtar dhe simbole të lidhura me të, elemente shtypi të këtyre prerjeve, si dhe monedha përkujtimore që përkujtojnë ngjarje të rëndësishme të historisë kombëtare si Lidhjen Shqiptare të Prizrenit, Kongresin e Manastirit dhe Shpalljen e Pavarësisë.

NETËT E MUZEUT

Duke filluar nga viti 2017, Muzeu i Bankës së Shqipërisë organizon rregullisht një cikël leksionesh të titulluara "Netët e Muzeut". Ky aktivitet ka si qëllim informimin e publikut të gjerë përmes leksioneve të mbajtura nga historianë, arkeologë, numizmatë, si edhe ekspertë të tjerë të fushës, mbi tematika të numizmatikës, historisë bankare dhe ekonomike, si dhe edukimit financiar.

Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2018 janë organizuar këto leksione:

- **"Gjergj Kastrioti Skënderbeu në pullën shqiptare", me lektor Prof. Dr. Jovan Basho,** 2 mars 2018

Gjatë këtij leksioni, lektori Basho prezantoi në mënyrë të detajuar emisionet e koleksionit filatelik shqiptar të lidhura me figurën e Heroit Kombëtar, Gjergj Kastrioti Skënderbeut, duke evidentuar kronologjikisht dhe ilustruar me pamje disa nga emisionet filatelike më interesante për Skënderbeun, gjatë viteve 1913-2005. Pjesë interesante e prezantimit ishin edhe disa kuriozitete lidhur me emetime të pullave postare të rralla, të kartëpostaleve me rëndësi historike, si dhe të gabimeve në emetime që i bëjnë pullat edhe më të kërkuara për filatelistët. Në përfundim të leksionit, dëgjuesit shijuan një ekspozitë të ndërtuar nga koleksioni i z. Basho me tematikë "Heroi Kombëtar, Gjergj Kastrioti Skënderbeu, në emisionet postare të viteve 1913-1918".

- **"Rëndësia e kulturës financiare për sipërmarrësit e rinj dhe për mirëqenien personale", me lektor z. Dritan Mezini,** 13 mars 2018

Më 13 mars 2018, në ambientet e Bankës së Shqipërisë, u zhvillua një leksion i ciklit "Netët e Muzeut", me temë "Rëndësia e kulturës financiare për sipërmarrësit e rinj dhe për mirëqenien personale". Leksioni u mbajt nga z. Dritan Mezini, Drejtor i Përgjithshëm i DM-consulting dhe portalit Duapunë.com, i

cili iu drejtua një publiku të përbërë kryesisht nga studentë dhe sipërmarrës të rinj, për t'i ndërgjegjësuar mbi rëndësinë e kulturës financiare si pjesë e formimit të përgjithshëm të tyre dhe çelës i suksesit të sipërmarrjes.

- **"Marrëdhëniet financiare të Ali Pashë Tepelenës", me lektor Dr. Dorian Koçi, Drejtor i Muzeut Historik Kombëtar,** 17 prill 2018

Ali Pashë Tepelena përfaqëson pa dyshim një nga personalitetet më karizmatike të epokës së tij, pasi jo vetëm qëndroi në pushtet për 30 vjet, por u bë aktor dhe faktor i shumë zhvillimeve panevropiane. Një aspekt pak i studiuar janë marrëdhëniet financiare të Pashallëkut të Janinës me Perandorinë Osmane, Venecian, Francën, Anglinë dhe Rusinë. Prandaj, dhe gjatë leksionit, u trajtuan çështje të tilla si burimet e të ardhurave dhe sistemi financiar në Perandorinë Osmane, burimet e të ardhurave në Pashallëkun e Janinës, taksat dhe tatimet e aplikuara, dhe regjimi juridik i tokës si burim i të ardhurave. Studimi i marrëdhënieve financiare të Pashallëkut të Janinës hedh dritë edhe në kontekstin historik të epokës së tij, si një nga etapat kalimtare të historisë sonë të afërme, me ndikime të rëndësishme gjeopolitike më vonë në shtetin e porsaformuar grek dhe në territoret shqiptare.

SEMINARI NJËJAVOR "MONEDHAT ANTIKE QË NGA SHFAQJA E TYRE (FILLIMI I SHEK. VII P.E.S.) DERI NË FUNDIN E PERANDORISË ROMAKE (FUNDI I SHEK. V E.S.)

30 prill - 7 maj 2018, Tiranë

Për herë të parë, Muzeu i Bankës së Shqipërisë zhvilloi seminarin njëjavor "Monedhat antike që nga shfaqja e tyre (fillimi i shek. VII p.e.s.) deri në fundin e Perandorisë Romake (fundi i shek. V e.s.). Në këtë seminar morën pjesë rreth 30 persona, përfshirë studiues, koleksionistë dhe studentë të Universitetit të Tiranës. Seminari, i ideuar për fillestarët në degën e numizmatikës, i pajisi pjesëmarrësit me njohuri të përgjithshme mbi botën paramonetare, ekonominë antike, monedhat e qyteteve ilire, monedhat perandorake romake

dhe perandorake republikane. Në ditën e fundit të seminarit, pjesëmarrësit u prezantuan edhe me ushtrime praktike mbi mënyrën se si studiohen vulat, si ndërtohet një korpus monetar, si studiohen, datohen, restaurohen dhe konservohen monedhat antike.

KREMTOHET JAVA E PARASË

12 mars 2018, Tiranë, Shqipëri

Në datat 12–18 mars 2018, Banka e Shqipërisë, në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Shoqatën Shqiptare të Bankave, dhe partnerë të tjerë, organizoi për të pestin vit radhazi aktivitetin e Javës së Parasë.

Kjo javë është një festë mbarëbotërore e parasë, e cila ka për qëllim ndërgjegjësimin e fëmijëve dhe të rinjve për të qenë qytetarë të ardhshëm të përgjegjshëm dhe të aftë për të marrë vendime financiare të mirëmenduara.

Në aktivitetin çelës të Javës së Parasë 2018, Guvernatori Sejko theksoi angazhimin serioz të Bankës së Shqipërisë në edukimin financiar, përmes zbatimit të programeve edukative dhe hartimit të teksteve mësimore dedikuar arsimit fillor dhe atij të mesëm. Ai nënvizoi gjithashtu moton e aktivitetit "Paraja: Ç'të mbjellësh, do të korrësh", i cili thekson rëndësinë e çështjeve që lidhen me paranë. Guvernatori Sejko shtoi se përtej mesazhit që banka dëshiron të përçojë, vlerëson frymëzimin, origjinalitetin dhe të menduarit aktiv, si mënyra më efektive për përthithjen e kësaj teme sa komplekse, aq edhe të prekshme. Më tej aktiviteti vijoi me ceremoninë e ndarjes së çmimeve për fituesit e tre konkurseve të organizuara nga Banka e Shqipërisë dhe Shoqata Shqiptare e Bankave me rastin e kësaj javë.

AKTIVITETET SOCIALE TË BANKËS SË SHQIPËRISË

Banka e Shqipërisë, në kuadër të përgjegjësisë sociale, ndërmerr vazhdimisht nisma të ndryshme humanitare.

Në datë 2 prill 2018, ashtu si vitet e kaluara, ndërtesa qendrore e Bankës së Shqipërisë u ndriçua në ngjyrë blu për të shënuar Ditën Botërore të Autizmit, si pjesë e një iniciative të përbashkët kombëtare për rritjen e ndërgjegjësimit mbi të.

Me rastin e 1 Qershorit, "Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve", punonjësit e Bankës së Shqipërisë u erdhën në ndihmë fëmijëve të shtëpisë së Foshnjës "Lulet e Vogla" dhe Shtëpisë Speciale Korçë. Punonjësit e Bankës së Shqipërisë dhanë kontributin e tyre vullnetar, duke dhuruar artikuj të ndryshëm, libra për fëmijë, si dhe kontribut monetar, për t'i pajisur këto institucione me logjistikën e nevojshme për mirëqenien dhe edukimin e këtyre fëmijëve.

Me rastin e 14 Qershorit, "Ditës Botërore të Dhurimit të Gjakut", punonjësit e Bankës së Shqipërisë iu bashkuan nismës së dhurimit vullnetar të gjakut.

DHURONI
GJAK

DHURONI
GJAK